

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“LVD” SH.P.K**

**NENI 1**  
FORMIMI

Sot, më date 06.02.2020 shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “LVD” Sh.p.k themelohet në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”. Kjo shoqëri krijohet nga:

1. Znj.Mimoza Kalia, e bija e Ademit dhe Huzries, e datëlindjes 05.05.1977, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, banuese në Adresën Rr. “Dervish Hima”, Pall Amb.3, K.12, Ap.93, identifikuar me Letërmjoftimin ID më Nr.pasaporte H75505181F, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Z.Florian Kalia, i biri i Ademit dhe Huzries, e datëlindjes 06.03.1982, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë, banues në Adresën Rr. “Reshit Petrela”, Pall. Usluga, Kati 10, identifikuar me Letërmjoftimin ID më Nr.030451516 dhe Nr. Personal I20306149T, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Organi administrues i Shoqërisë ka të drejtë të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

**NENI 2**  
SELIA

Selia e Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar “LVD” Sh.p.k është në adresën: **Njësia Administrative Nr.9, Rr.“Jordan Misja”, Pallatet Usluga, Seksioni D, Kati 7, Ap.44, Tiranë, Shqipëri**. Ortaët mund të vendosin për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter.

**NENI 3**  
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “LVD” Sh.p.k është e pacaktuar.

**NENI 4**  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “LVD” Sh.p.k. do të jetë:

1. Krijimi dhe zhvillimi i zyrave të ndërmjetësimit për pasuritë e paluajtshme ose në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të veçantë Franchising.

2. Shërbimi si përfaqësues shitjeje e marketing-u, agjent shitjeje pasurish të paluajtshme për shoqëri vendase dhe të huaja. Angazhimi në shitjen me shumicë dhe pakicë të çdo lloj pasurie, hapje e dyqaneve, degëve apo zyrave nëse do të jetë e nevojshme në funksion të realizimit të qëllimit të Shoqërisë.
3. Konsulencë financiare dhe ligjore në fushën e pasurive të paluajtshme (godina banimi, tregtare dhe industriale) si edhe në çdo fushë tjeter të lidhur me të, përfaqësim ligjor pranë çdo organi administrativ kompetent ligjor në fushat e mësipërme, ndërmjetësim për zgjidhjen e këtyre konflikteve.
4. Ndërmjetësim në lidhje me shitjen e pasurive pasurive të paluajtshme, përfshirë shitjen e pasurive të paluajtshme koncensionare.
5. Vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe realizimin e të gjitha llojeve të trajnimeve që lidhen me arritjen e qëllimeve të mësipërme.

Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të mësipërme, shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjeter të lidhur, ndihmës, të ngashëm, plotësues apo te dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Për përmbushjen e objektit të saj, Shoqëria mund të:

- a) Të zoterojë direkt ose indirekt pjesëmarrje në shoqëri dhe/ose sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja që kryejnë aktivitete të njëta, të ngashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose që mund të ndihmojnë në realizimin e objektit të Shoqërisë;
- b) Të themelojë degë, zyra përfaqësimi dhe në per gjithësi të kryejë çdo aktivitet tjeter që nuk është i ndaluar nga ligji.

## NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë “LVD” Sh.p.k, është 100.000 (njëqind mijë) Lekë, ku:

- Ortaku Znj.Mimoza Kalia zoteron një kuotë të barazvlefshme me 75% të kapitalit themeltar.
- Ortaku Z.Florian Kalia zoteron një kuotë të barazvlefshme me 25% të kapitalit themeltar.

Ky kapital është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Kuotat e Ortakëve regjistrohen në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

## NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese të shoqërisë “LVD” Sh.p.k janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administratori i shoqërisë, është Z.Florian Kalia, i datëlindjes 06.03.1982, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë, Shqipëri, e identifikuar me Letërnjoftimin ID me

Nr.030451516 dhe Nr. Personal I20306149T, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

#### **NENI 7**

Të drejtat dhe detyrat e Asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj shprehen në statut i cili së bashku me aktin e themelimit përbëjnë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbjejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

#### **NENI 8**

Veprimtarinë e saj, shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjisacionin Shqiptar.

#### **NENI 9**


Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore, zgjidhen me Ndërmjetësim me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjisacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japid rezultat, atëhere zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me pergjegjësi të kufizuar “**LVD**” Sh.p.k në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë. Në këte ditë shoqëria “**LVD**” Sh.p.k njihet si person juridik.

Ky akt themelimi u hartua në tre ekzemplarë me vlera të njëjtë juridike dhe pasi iu lexua themeluesit, u nënshkrua rregullisht prej tij.

#### **O R T A K E T**

**Mimoza Kalia**



**Florian Kalia**

